



**Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada -**  
**Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i**  
**Sporta**  
**/ Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

Prishtinë, Mars 2023

**THIRRJE PUBLIKE PËR POLITIKËN PROGRAMORE**  
**“SPORTI PËR TË MOSHUARIT”**

Ndër prioritetet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për vitin 2023 është ofrimi i mundësive për pjesëmarrje në aktivitet fizik të organizuar për të moshuarit të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës. Të qenurit rregullisht aktiv në aspektin fizik ndihmon të moshuarit të qëndrojnë të pavarur, të parandalojnë problemet shëndetësore që vijnë me moshën si dhe të përmirësojnë shëndetin për ata të cilët tashmë kanë sëmundje apo aftësi të kufizuara. Duke e njohur ndikimin që Covid 19 ka pasur përgjatë dy viteve të fundit në shëndetin e përgjithshëm publik, e në veçanti tek moshat e shtyera, MKRS ka ndarë fond të veçantë për hartimin dhe zbatimin e projekt-propozimit i cili do t’ua mundësojë të moshuarve të jenë pjesëmarrës në aktivitet të rregullt fizik.

Në funksion të kësaj politike programore përmes së cilës MKRS synon rritjen e pjesëmarrjes së të moshuarve në aktivitet fizik, MKRS fton organizatat joqeveritare (të regjistruara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare në Republikën e Kosovës) të cilat fushëveprimtari kanë sportin, të aplikojnë me projekte të cilat përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Hartimi i programit i cili ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit fizik të organizuar për të moshuarit në Republikën e Kosovës në përputhje me objektivat e Ministrisë së Kulturës, Rinisë, dhe Sportit;
- Zbatimi i programit përmes pilotimit të tij në 3 komuna të Kosovës përgjatë

periudhës Maj - Tetor 2023;

- Finalizimi i programit “Sporti për të moshuarit” i cili gjatë vitit 2024 do të zbatohet në nivel shtetëror.

**Projekti do të zbatohet gjatë periudhës maj 2023 deri në tetor 2023 për përmbushjen e objektivave specifike përmes aktiviteteve si në vijim:**

- Bashkëpunimi i plotë me MKRS dhe partnerët e tjerë institucionalë deri në realizimin e projektit;
- Hartimi i planit të punës dhe konsolidimi i metodologjisë së programit në koordinim të ngushtë me MKRS dhe partnerët e tjerë institucionalë;
- Rekrutimi i stafit me përvojë për hartimin dhe zbatimin e programit sportiv që do të realizohet me të moshuarit;
- Përfundimi i modulit të trajnimit të stafit për realizimin e programit sportiv me të moshuarit;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet relevante të nivelit lokal apo/ose qendror për sigurimin e hapësirave të nevojshme për zbatim të programit;
- Sigurimi i pajisjeve të nevojshme sportive për zbatimin e programit në terren;
- Organizimi i sesioneve informuese rreth përmbajtjes së programit dhe promovimit të tij tek 3 komunat pilotuese si dhe akterët e tjerë relevantë që do të përfshihen direkt apo indirekt në projekt;
- Hartimi i agjendës së aktiviteteve të cilat do të realizohen në kuadër të programit në të tri komunat pilotuese;
- Hartimi i pyetësorit që i shërben plotësimit të pilot-projektit për shndërrim të tij në program shtetëror duke u bazuar në nevojat e pjesëmarrësve në aktivitetet të cilat do të realizohen në kuadër të projektit;
- Hartimi i draftit final të programit duke u referuar në vlerësimin e programit të pilotuar, me qëllim të zbatimit të tij në të ardhmen në nivel shtetëror;

**Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (stafi i angazhuar për realizimin e projektit nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucionet vartëse të saj)

- Vërtetimin që OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK).

**Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- A është dorëzuar portfolio me dëshmi të aktiviteteve në fushën e sportit gjatë të paktën dy vitet të fundit (në dokument të listohen projektet dhe aktivitetet me përshkrime të shkurtër, nuk duhet të përmbajë fotografi dhe nuk duhet të jetë më i gjatë se 2 faqe)
- A është OJQ-ja e profilizuar në fushën e sportit, në veçanti në promovimin e sportit dhe aktivitetit fizik si mekanizëm kyç për një jetë më të shëndetshme;
- Të ofrojnë pasqyrat financiare për 2 vitet e fundit, përkatësisht vitet, 2021 dhe 2022. Shuma mesatare e qarkullimit vjetor për vitet paraprake (2021-2022) duhet të jetë së paku 20,000.00 EUR;
- Të integrojnë procesin e Auditimit të jashtëm dhe Vlerësimit të ndikimit social dhe ekonomik të programit vjetor të OJQ-së në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike;
- Të integrojnë komponentën e promovimit të aktivitetit fizik tek shoqëria kosovare në përgjithësi në kuadër të projekt-propozimit me të cilin aplikojnë në këtë thirrje.
- A është i përcaktuar ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit?
- A posedon OJQ-ja kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet të planifikuara të projekt - propozimit (a kanë aftësitë e duhura për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë thirrje të cilat duhet të dëshmohen me CV);
- A posedon OJQ-ja kapacitete të mjaftueshme të menaxhimit (duke përfshirë personelin e propozuar për zbatimin e aktiviteteve, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
- A janë aktivitetet e projektit/ programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- Nëse është prezantuar plani dinamik, i zbrërthyer në aktivitete, afat kohor, bartës, përgjegjës, dhe kosto të përafërt për përmbushjen e aktiviteteve të projekt - propozimit;
- A janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit?

**Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:**

**Vlerësimi administrativ:** Identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse.

**Vlerësimi përmbajtësor që identifikon:**

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e sportit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike;
- Nëse kostot e kërkesës së projekt-propozimit janë reale karshi çmimeve të tregut;
- Nëse aplikuesi ka përfunduar të gjitha obligimet paraprake ndaj MKRS-së (nëse është përfitues i thirrjeve paraprake);

**Kush mund të aplikojë:**

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

**Përmes kësaj thirrjeje dhe për hartimin dhe zbatimin e këtij projekti, do të përzgjedhet vetëm 1 (një) organizatë jo-qeveritare.**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë dërguar/pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune pas hapjes së thirrjes dhe përfundon me datën **20 mars 2023, në ora 23.59.**

**Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimi përfitues në këtë thirrje publike duhet të zbatohet në tërësi deri më **30.11.2023**, ndërsa procedurat e raportimit dhe dorëzimit të draftit të plotësuar të programit duhet të përfundohen deri më datën **15.12.2023.**

**Shkalla e mbështetjes:**

- Shuma maksimale e mbështetjes 100,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes 50,000.00 Euro

**Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:**

- Formulari i aplikacionit për projekt;
- Formulari i propozim buxhetit;
- Formulari për deklaratën e mungesës së financimit të dyfishtë;
- Formulari për deklaratën e partneritetit (nëse ka);
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e numrit fiskal të OJQ-së;
- Portfolio e aktiviteteve gjatë dy viteve të fundit;
- Pasqyrat financiare për dy vitet e fundit nga ATK (2021 dhe 2022);
- Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në dy vitet e fundit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

**Mënyra e Aplikimit:**

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në web-faqen e MKRS-së: [www.mkrs-ks.org](http://www.mkrs-ks.org). OJQ-të duhet të aplikojnë në thirrje vetëm përmes postës elektronike në email adresën: [dep.sportit@rks-gov.net](mailto:dep.sportit@rks-gov.net) Projekt-propozimet e shtypura në formë fizike nuk do të pranohen për shqyrtim.

**Titulli që duhet shënuar në subjekt të emaili-it:**

*Sporti për të moshuarit\_Emri i OJQ-së*

**Më shumë informacione rreth thirrjes publike:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike “Sporti për të moshuarit” mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën [fidan.shatri@rks-gov.net](mailto:fidan.shatri@rks-gov.net), jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së thirrjes publike.